


TaxNews

Maj 2018
May 2018

SPECIAL



Deloitte.

I. Ligji nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"

Në Fletoren Zyrtare nr. 79, datë 30.05.2018, u publikua Ligji nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" ("Ligji i ri"), i cili do të zëvendësojë Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" ("Ligji aktual"), me efekt nga 01.01.2019. Ligji i ri është pjesërisht i përafuar me legjislacionin e Bashkimit Europian mbi pasqyrat financiare dhe raportet e tjera të njësive ekonomike.

Më poshtë kemi përmbledhur ndryshimet kryesore që ky Ligj i ri sjell krahasimisht me Ligjin aktual.

Koncepte të reja

Ligji i ri përfshin përkufizime të disa termave të cilat mungojnë në Ligjin aktual si 'njësi ekonomike financiare e tipit "holding"', 'grup njësisht ekonomike', 'interes në pjesëmarrje', 'pasqyra financiare të konsoliduara', 'monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes', 'personi përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare' etj. Gjithashtu, Ligji i ri koordinon më mirë termat dhe parashikimet me ligjin nr. 10 091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", të ndryshuar (lutemi referojuni [Tax News-it tonë të majit 2016](#)).

Klasifikimi i njësive ekonomike

Ligji cakton klasifikimin e njësive ekonomike sipas tre kritereve: totali i aktiveve, totali i të ardhurave nga veprimtaria ekonomike dhe numri mesatar i punonjësve gjatë periudhës raportuese. Njësitë klasifikohen në një kategori nëse përmbushin të paktën dy nga tre kriteret përkatëse, siç paraqiten në tabelën më poshtë:

I. Law no. 25/2018 "On accounting and financial statements"

In the Official Gazette no. 79, dated 30.05.2018 has been published the Law no. 25/2018 "On accounting and financial statements" ("New Law"), which will replace the Law no. 9228, dated 29.04.2004 "On accounting and financial statements" ("Current Law"), with effect as of 01.01.2019. The New Law is partly harmonized with the European Union legislation on financial statements and other reports of economic entities.

Below we have summarized the main amendments brought by this New Law as compared to the Current Law.

New concepts

The New Law includes definitions of certain concepts that are missing in the Current Law, such as 'financial "holding" entities', 'group of economic entities', 'participating interest', 'consolidated financial statements', 'functional currency and presentation currency', 'responsible person for preparation of financial statements', etc. Furthermore, the New Law coordinates better the terms and provisions with the Law no. 10091, dated 05.03.2009 "On statutory audit, organization of the professions of statutory auditor and certified accountant", as amended (please refer to our [Tax News of May 2016](#)).

Classification of economic entities

The New Law determines the classification of economic entities according to three criteria: total assets, total revenues from economic activity and the average number of employees during the reporting period. Entities are classified under one category if they fulfill at least two of three respective criteria, as presented in the table below:

Lloji i njësisë	Kriteri 1	Kriteri 2	Kriteri 3
	Totali i aktiveve	Të ardhurat e veprimtarisë	Numri mesatar i punonjësve
Mikronjësi ekonomike	≤15 milionë lekë	≤30 milionë lekë	≤10
Njësi ekonomike të vogla	≤150 milionë lekë	≤300 milionë lekë	≤50
Njësi ekonomike të mesme	≤750 milionë lekë	≤1,500 milionë lekë	≤250
Njësi ekonomike të mëdha	>750 milionë lekë	>1,500 milionë lekë	>250

Type of entity	Criteria 1	Criteria 2	Criteria 3
	Total assets	Revenues from economic activity	Average number of employees
Micro-economic entities	≤ ALL 15 million	≤ ALL 30 million	≤10
Small entities	≤ ALL 150 million	≤ ALL 300 million	≤50
Medium-sized entities	≤ ALL 750 million	≤ ALL 1,500 million	≤250
Large entities	> ALL 750 million	> ALL 1,500 million	>250

Një njësi e klasifikuar në një kategori, riklasifikohet në kategori tjetër vetëm nëse tejkalon apo bie nën kufijtë e të paktën dy kriterëve për dy periudha raportuese radhazi.

An entity classified under one category is reclassified into another category only if it exceeds or falls below the limits of at least two criteria for two consecutive reporting periods.

Në mënyrë të ngjashme, Ligji i ri cakton edhe klasifikimin e grupeve të njësive ekonomike (për efekte të përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara dhe raporteve të tjera në nivel grupi) kur vlerat e tyre pas konsolidimit përmbushin të paktën dy nga tre kriteret përkatëse:

Similarly, the New Law also establishes the classification of groups of economic entities (for the purpose of preparation of consolidated financial statements and other reports at group level) when their values after consolidation meet at least two from three of the respective criteria:

Lloji i grupit të njësive	Kriteri 1	Kriteri 2	Kriteri 3
	Totali i aktiveve	Të ardhurat e veprimtarisë	Numri mesatar i punonjësve
Grupe të vogla	≤150 milionë lekë	≤300 milionë lekë	≤50
Grupe të mesme	≤750 milionë lekë	≤1,500 milionë lekë	≤250
Grupe të mëdha	>750 milionë lekë	>1,500 milionë lekë	>250

<i>Type of groups of entities</i>	<i>Criteria 1</i>	<i>Criteria 2</i>	<i>Criteria 3</i>
	<i>Total assets</i>	<i>Revenues from economic activity</i>	<i>Average number of employees</i>
Small groups	≤ ALL 150 million	≤ ALL 300 million	≤50
Medium-sized groups	≤ ALL 750 million	≤ ALL 1,500 million	≤250
Large groups	> ALL 750 million	> ALL 1,500 million	>250

Kufijtë për dy prej kritereve, konkretisht totalit të aktiveve dhe totalit të të ardhurave nga veprimtaria ekonomike, do të rriten çdo tre vjet me qëllim përafrimin e plotë të tyre deri në vitin 2028 me kriteret e përcaktuara në legjislacionin përkatës të Bashkimit Europian.

Standardet e zbatueshme

Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar (SNK/SNRF) do të zbatohen vetëm nga njësitë ekonomike me interes publik si dhe rregullatorët e njësive ekonomike me interes publik që veprojnë në fushën kreditimit dhe sigurimeve, me disa përjashtime. Të gjitha njësitë e tjera do të zbatojnë Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), por do të kenë mundësinë të zbatojnë SNK/SNRF në mënyrë vullnetare.

‘Njësi ekonomike me interes publik’, sikurse kemi përmbledhur edhe në Tax News tonin të majit 2016, do të konsiderohen të gjitha njësitë ekonomike të listuara në bursë; bankat si dhe subjektet e tjera financiare jo-banka; shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit; shoqëritë administruese të fondeve të investimeve kolektive; shoqëritë administruese të fondeve të pensionit vullnetar; si dhe shoqëritë e tjera të cilat janë të rëndësishme për interesin e publikut për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

The limits for two criteria, specifically for total assets and total revenues from economic activity, will increase every three years until 2028 with the purpose of full harmonization of these criteria with the ones provided in the respective European Union legislation.

Applicable standards

International Accounting Standards and International Financial Reporting Standards (IAS/IFRS) will be applicable only to public interest entities, as well as to regulators of public interest economic entities that perform their activity in crediting and insurance industry, with certain exemptions. All other entities will apply National Accounting Standards (NAS), but will have the possibility to apply IAS/IFRS voluntarily.

‘Public interest entities’, as it is summarized in our Tax News of May 2016, will be considered all companies listed in stock exchange markets; bank and non-bank financial institutions; insurance and reinsurance companies; investment and voluntary pension funds; as well as other companies that are relevant to the public interest due to the nature of their business, their size or the number of their employees, determined by a Council of Ministers decision.

Periudha raportuese

Kohëzgjatja normale e periudhës raportuese është 12 muaj nga data 1 janar deri më 31 dhjetor.

Ligji i ri parashikon se kohëzgjatja e periudhës raportuese, në rastet e nisjes apo mbylljes së aktivitetit, mund të jetë më e shkurtër ose më e gjatë se 12 muaj, por, gjithsesi, nuk mund të jetë më e shkurtër se 3 muaj dhe as më e gjatë se 15 muaj.

Pasqyrat financiare të konsoliduara

Grupet ekonomike, përveç grupeve të vogla, hartojnë pasqyra financiare të konsoliduara. Përrjashtimisht, grupet e vogla janë subjekt i këtij detyrimi vetëm nëse ndonjëra prej njësive të grupit është njësi me interes publik.

Përbërësit e pasqyrave financiare

Përbërësit e pasqyrave financiare ndryshojnë në varësi të klasifikimit të njësisë përkatëse ekonomike:

Reporting period

The regular reporting period duration is 12 months, starting from 1st of January until 31st of December. The New Law provides that the duration of the reporting period may be shorter or longer than 12 months in cases of initiation or termination of the economic activity but may not, however, be shorter than 3 months or longer than 15 months.

Consolidated financial statements

Economic groups, with the exception of small groups, prepare consolidated financial statements. Exceptionally, small groups are subject to this obligation only if one of the group's entities is an entity of public interest.

Financial statements components

Components of financial statements vary depending on the classification of the respective economic entities:

Lloji i njësisë	Pasqyra e pozicionit financiar	Pasqyra e të ardhurave e shpenzimeve	Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	Pasqyra e flukseve monetare	Pasqyra e ndryshimeve në kapital	Shënimet shpjeguese
Mikronjësi (jo 'holding')	Po, të shkurtuar	Po, të shkurtuar	Jo	Jo	Jo	Po, të shkurtuara
Njësi ekonomike të vogla	Po	Po	Jo	Jo	Jo	Po
Njësi ekonomike të mesme	Po	Po	Po	Po	Po	Po
Njësi ekonomike të mëdha	Po	Po	Po	Po	Po	Po
Njësi të vogla, të mesme e të mëdha me interes publik	Po	Po	Po	Po	Po	Po
OJF	Po	Po, në trajtën e Pasqyrës së Aktiviteteve	Jo	Po	Jo	Po

<i>Type of entity</i>	<i>Statement of Financial Position</i>	<i>Statement of Profit or Loss</i>	<i>Statement of Other Comprehensive Income</i>	<i>Statement of Cash Flows</i>	<i>Statement of Changes in Equity</i>	<i>Explanatory Notes</i>
Micro-economic entities (not 'holding')	Yes, simplified	Yes, simplified	No	No	No	Yes, simplified
Small entities	Yes	Yes	No	No	No	Yes
Medium-sized entities	Yes	Yes	Yes	Yes	Yes	Yes
Large entities	Yes	Yes	Yes	Yes	Yes	Yes
Small, medium and large public interest entities	Yes	Yes	Yes	Yes	Yes	Yes
Not for profit organizations	Yes	Yes, in the form of Statement of Activities	No	Yes	No	Yes

Të dhënat e detyrueshme të shënimeve shpjeguese

Njësitë ekonomike të mesme, të mëdha dhe ato me interes publik duhet të paraqesin një numër të dhënash të detyrueshme si pjesë e shënimeve shpjeguese të pasqyrave financiare si p.sh.: numri mesatar i punonjësve i ndarë sipas kategorive, shuma e pagave për anëtarët e organeve drejtuese e ekzekutive, të dhënat mbi njësitë ekonomike në të cilat ka interesa pjesëmarrës apo kuota, informacione mbi njësitë e grupit që hartojnë pasqyra financiare të konsoliduara, tarifat e dakorduara me audituesit ligjorë për shërbimin e auditimit si dhe për shërbime të tjera si këshillimore, tatimore etj.

Raporte dhe pasqyra të veçanta

Raportet shtesë të mëposhtme janë të detyrueshme për disa prej njësive ekonomike:

Obligatory information of explanatory notes

Medium-sized, large and public interest entities should present a number of obligatory information as part of explanatory notes to the financial statements, such as: average number of employees for each category, amount of salaries for governing and executive bodies, information about economic entities where it has participating interests or owns shares, information over group entities that prepare consolidated financial statements, agreed fees with auditors for the purposes of statutory audit as well as other services such as general advisory, tax advisory, etc.

Specific reports and statements

The below additional reports are obligatory for some economic entities:

<i>Lloji i njësisë</i>	<i>Raport i ecurisë së veprimtarisë</i>	<i>Raport i drejtimit të brendshëm*</i>	<i>Raport jo-financiar*</i>	<i>Raport i pagesave që u bëhen institucioneve shtetërore</i>
Mikronjësi	Jo	Jo	Jo	Jo
Njësi ekonomike të vogla	Jo	Jo	Jo	Jo
Njësi ekonomike të mesme	Po	Jo	Jo	Jo
Njësi ekonomike të mëdha	Po	Jo	Jo	Po, nëse operojnë në industrinë nxjerrëse ose shfrytëzimin e lëndëve drusore pyjore
Njësi të vogla, të mesme e të mëdha me interes publik	Po	Po	Po, për njësitë e mëdha me >500 të punësuar	Po, nëse operojnë në industrinë nxjerrëse ose shfrytëzimin e lëndëve drusore pyjore
OJF	Jo, nëse totali i aktiveve ose të ardhurave <30 milionë lekë	Jo	Jo	Jo

(*) Ky raport përfshihet në raportin e ecurisë së veprimtarisë.

<i>Type of entity</i>	<i>Performance progress report</i>	<i>Management report*</i>	<i>Non-financial report*</i>	<i>Report on payments made to governmental institutions</i>
Micro-economic entities	No	No	No	No
Small entities	No	No	No	No
Medium-sized entities	Yes	No	No	No
Large entities	Yes	No	No	Yes, if it operates in the extractive industry or industrial forest exploitation
Small, medium and large public interest entities	Yes	Yes	Yes, for large entities with >500 employees	Yes, if it operates in extractive industry or industrial forest exploitation
Not for profit organizations	Not for profit organizations	No	No	No

*This report is included in the performance progress report.

Nënshkrimi i pasqyrave financiare

Përveç përfaqësuesit ligjor të njësive, pasqyrat financiare duhet të mbajnë nënshkrimin edhe të personit përgjegjës për hartimin e tyre. Ky është personi i punësuar, personi fizik i licencuar si kontabilist i miratuar apo auditues ligjor, si dhe personi juridik i organizuar si shoqëri auditimi apo shoqëri kontabiliteti, që ofron shërbimin e kontabilitetit, sipas kontratës së punës apo kontratës së shërbimit që ka me njësinë ekonomike dhe mban përgjegjësinë për hartimin e pasqyrave financiare.

Detyrimi për depozitim e publikim

Brenda 7 muajve nga data e raportimit, të gjitha njësitë ekonomike do të depozitojnë për publikim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit a ndonjë autoriteti tjetër përgjegjës ku janë regjistruar (a) pasqyrat financiare vjetore, (b) raportin e ecurisë së veprimtarisë, (c) raportin e auditimit, kur këto dokumente janë të detyrueshme.

Njësitë ekonomike të mesme e të mëdha si dhe ato me interes publik do të kenë edhe detyrimin t'i publikojnë këto dokumenta në faqet e tyre të internetit.

Njësitë ekonomike jofitimprurëse detyrohen të publikojnë pasqyrat financiare vjetore si dhe raportin e performancës së veprimtarisë në faqet e tyre zyrtare të internetit, vetëm nëse totali i aktiveve ose i të ardhurave do të tejkalojë 30 milionë lekë.

Rregullime të veçanta lidhur me shpërndarjen e fitimeve

Ligji i ri parashikon kufizimin e vlerave të fitimit që mund t'u shpërndahen aksionerëve/ortakëve në rastet kur njësia ka kosto zhvillimi të kapitalizuara në aktive dhe ende të pa-amortizuara plotësisht, ose kur ka njohur të ardhura nga interesat në pjesëmarrje të cilat nuk janë arkëtuar plotësisht.

Signing of financial statements

Besides the legal representative of the entity, the financial statements must be signed also by the person responsible for their preparation. This is the employed person, physical person licensed as certified accountant or statutory auditor, as well as legal persons organized as audit companies or accounting companies that provide accounting services, which in accordance with the employment contract or service agreement concluded with the economic entity holds responsibility for the preparation of the financial statements.

Submission and publication obligation

Within 7 months from the reporting date, all economic entities will submit for publication to the National Business Center or any another responsible authority where they might be registered: (a) annual statutory financial statements, (b) performance progress report, (c) audit report, when these documents are compulsory.

Medium-sized and large economic entities, as well as public interest entities, will have the obligation to publish these documents in their websites.

Non for profit organizations are obliged to publish annual statutory financial statements and performance progress reports in their official websites, only if total assets or total revenues exceeds ALL 30 million.

Special regulation related to profit distribution

The New Law provides the limitation of the amounts of profit that can be distributed to shareholders in cases where the economic entity has not fully amortized capitalized development costs, or when it has recognized income from participating interest which are not fully collected.

Ruajtja e dokumentave kontabël

Afati i ruajtjes së dokumenteve kontabël mbetet i pandryshuar. Dokumentet kontabël vijojnë të ruhen për 10 vjet rresht pas mbylljes së periudhës raportuese së cilës i përkasin. Megjithatë, në ndryshim nga Ligji aktual i cili nuk e kufizon, Ligji i ri përcakton se ato duhet të ruhen në selinë ku zhvillohet aktiviteti ekonomik i njësisë ekonomike.

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK)

Krahasimisht me parashikimet e Ligjit aktual, Ligji i ri parashikon disa ndryshime në numrin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit (7 përkundrejt 9 anëtarë aktualisht), përbërjen (strukturat të cilat kanë të drejtë të propozojnë anëtarë), emërimin e tyre (nga Ministria e Financave përkundrejt Këshillit të Ministrave aktualisht), si dhe detyrimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit për raportimin e veprimtarisë vjetore të tij brenda 3-mujorit të parë të vitit pasardhës.

Retention of accounting documents

The rule for retention of accounting documents remains for 10 years in a row after closing of the reporting period to which they belong. However, contrary to the Current Law which does not provide any limitation in this regard, the New Law stipulates that accounting documents should be retained at the headquarters where the economic activity of the entity is conducted.

National Accounting Council (NAC)

In comparison with the provisions of the Current Law, the New Law provides some amendments in the number of members of the National Accounting Council (7 members proposed against 9 members currently), the composition (entities/institutions that have the right to propose members), their appointment (by the Minister of Finance instead of by the Council of Ministers as it is currently provided), and the obligation of the National Accounting Council to report its annual performance within the first quarter of the following year.

Deloitte Contacts

Olindo Shehu, CPA

Partner | Tax & Legal Services
Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Elbasanit", Pallati prane Fakultetit
Gjeologji Miniera
Tirana | Albania
Mob: +355 68 60 33 116
E-mail: oshehu@deloitteCE.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 263,900 professionals are committed to becoming the standard of excellence.